

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 57 datë 24.4.2023

PËR

**DISA SHTESA NË URDHRIN NR. 94, DATË 20.5.2019,
TË KRYEMINISTRIT, "PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN
DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE
TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN"**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të pikave 3 e 7, të kreut VIII, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar,

URDHËR O J:

1. Në urdhrin nr.94, datë 20.5.2019, të Kryeministrit, të bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 1, të kreut I, të shtohen pikat 1.1 dhe 1.2, me këtë përmbajtje:

"1.1. Krijimin e grupeve ndërinstytucionale të punës për hartimin e:

a) udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës (që përfshin kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" dhe kapitullin 24 "Drejtësia, liria dhe siguria"), në kuadër të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;

- b) udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike (kriteri politik), në kuadër të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- c) udhërrëfyesit për reformën në administratën publike (kriteri politik), në kuadër të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.”.

1.2. Rregullat e punës për grupet ndërinstitucionale të punës për hartimin e udhërrëfyesve për shtetin e së drejtës, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformës në administratën publike të përcaktohen me udhëzim të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.”.

- b) Pas pikës 2, të kreut II, të shtohen pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.1. Grupi ndërinstitucional i punës, për hartimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës, në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ka detyrat e mëposhtme:

- a) Të përgatisë planin e punës për hartimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës;
- b) Të bashkërendojë punën e institucioneve për hartimin e udhërrëfyesit;
- c) Të identifikojë dhe të ftojë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë prej të cilëve mund të merret kontribut për hartimin e udhërrëfyesit dhe me të cilët duhet të konsultohet drafti i udhërrëfyesit;
- ç) Të informojë një herë në dy javë ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator për ecurinë e punës për hartimin e udhërrëfyesit;
- d) Të hartojë udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri;
- dh) Të nxisë zbatimin e masave të parashikuara në udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës;
- e) Të monitorojë ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në udhërrëfyes.

2.2. Grupi ndërinstitucional i punës, për hartimin e udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike, në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ka detyrat e mëposhtme:

- a) Të përgatisë planin e punës për hartimin e udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike;

- b) Të bashkërendojë punën e institucioneve për hartimin e udhërrëfyesit;
- c) Të identifikojë dhe të ftojë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë prej të cilëve mund të merret kontribut për hartimin e udhërrëfyesit dhe me të cilët duhet të konsultohet drafti i udhërrëfyesit;
- ç) Të informojë një herë në dy javë ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator për ecurinë e punës për hartimin e udhërrëfyesit;
- d) Të hartojë udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri;
- dh) Të nxisë zbatimin e masave të parashikuara në udhërrëfyesin për funksionimin e institucioneve demokratike;
- e) Të monitorojë ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në udhërrëfyes.

2.3. Grupi ndërinstitutional i punës për hartimin e udhërrëfyesit për reformën në administratën publike, në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ka detyrat e mëposhtme:

- a) Të përgatisë planin e punës për hartimin e udhërrëfyesit për reformën në administratën publike;
- b) Të bashkërendojë punën e institucioneve për hartimin e udhërrëfyesit;
- c) Të identifikojë dhe të ftojë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë prej të cilëve mund të merret kontribut për hartimin e udhërrëfyesit dhe me të cilët duhet të konsultohet drafti i udhërrëfyesit;
- ç) Të informojë një herë në dy javë ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator për ecurinë e punës për hartimin e udhërrëfyesit;
- d) Të hartojë udhërrëfyesin për reformën në administratën publike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri;
- dh) Të nxisë zbatimin e masave të parashikuara në udhërrëfyesin për reformën në administratën publike;
- e) Të monitorojë ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në udhërrëfyes.”.

c) Pas pikës 2, të kreut III, të shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1. Negociatorët janë përgjegjës për kryesimin e grupeve ndërinstitutionale të punës për hartimin e udhërrëfyesve për shtetin e së drejtës, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformës në administratën publike, ndërsa institucionet kontribuese përcaktohen në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij. Përfaqësuesit e institucioneve kontribuese, pjesë e grupeve të

punës, caktohen në nivelin “drejtor i përgjithshëm”/“drejtor drejtorie”, ose nëpunësi i caktuar nga titullari i institucionit”.

ç) Pas kreut V, të shtohet kreu V.1, me këtë përmbajtje:

“V/1. MBËSHTETJA E PUNËS SË GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR HARTIMIN DHE MONITORIMIN E UDHËRRËFYESVE PËR SHTETIN E SË DREJTËS, FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE, NË KUADËR TË NEGOCIATAVE PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN


1. Struktura përgjegjëse për integrimin pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe struktura përgjegjëse për integrimin pranë Ministrisë së Brendshme vepron si sekretariat teknik për grupin e punës për hartimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës, në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian nën drejtimin e drejtuesit të grupit të punës, duke siguruar mbështetje teknike dhe administrative dhe koordinimin e strukturave.
2. Struktura përgjegjëse për integrimin pranë Ministrisë së Drejtësisë vepron si sekretariat teknik për grupin e punës për hartimin e udhërrëfyesit për funksionimin e institucioneve demokratike, në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian nën drejtimin e drejtuesit të grupit të punës, duke siguruar mbështetje teknike dhe administrative dhe koordinimin e strukturave.
3. Struktura përgjegjëse për integrimin pranë Departamentit të Administratës Publike vepron si sekretariat teknik për grupin e punës për hartimin e udhërrëfyesit për reformën në administratën publike, në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian nën drejtimin e drejtuesit të grupit të punës, duke siguruar mbështetje teknike dhe administrative dhe koordinimin e strukturave.”.

d) Pas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet urdhrit, të shtohet shtojca nr.2, që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Negociatorët përgjegjës dhe institucionet kontribuese për hartimin e udhërrëfyesve për shtetin e së drejtës, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformës në administratën publike caktojnë anëtarët dhe

anëtarët zëvendësues të grupeve të punës dhe ia përcjellin drejtuesit të grupit përkatës të punës, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



SHTOJCA NR.2: INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE KRYEUSE DHE KONTRIBUESE PËR HARTIMIN E UDHËRRËFYESVE SHETI I SË DREJTËS, FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE, REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

UDHËRRËFYESI	NËNKAPITUJT	DREJTUES	INSTITUCIONET KONTRIBUESE	SEKRETARIATI TEKNIK
Shteti i së Drejtës	1. Sistemi gjyqësor 2. Politikat kundër korrupsionit 3. Të drejtat e njeriut 4. Lufta kundër krimit të organizuar 5. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës 6. Lufta kundër terrorizmit 7. Migracioni (i rregullt dhe jo) 8. Azili 9. Politikat e vizave 10. <i>Shtengen</i> dhe kufijtë e jashtëm 11. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale 12. Sistemi doganor (referuar kapitullit 29) 13. Mbrojtja e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)	- Negociatori i kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” - Negociatori i kapitullit 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”	- Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë - Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe institucionet e saj të varësisë - Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë (MIE) dhe institucionet e saj të varësisë - Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe institucionet e saj të varësisë - Ministria e Kulturës (MK) dhe institucionet e saj të varësisë - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe institucionet e saj të varësisë - Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe institucionet e saj të varësisë - Banka e Shqipërisë (BSSH) - Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) - INSTAT - Kuvendi - Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) - Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) - Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) - Prokuroria e Përgjithshme (PP) - Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale (KDIMDP) - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) - Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) - Departamenti i Administratës Publike (DAP) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Gjykata e Lartë - Gjykata Kushtetuese - Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) - Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) - Komisionerët Publikë - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK)	Struktura përgjegjëse për integrimin pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme

			- Shkolla e Magjistraturës - Kryeministria - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) - Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike - AKCESK - Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) - Komiteti Shtetëror i Minoriteteve - Komiteti Shtetëror i Kulteve	Struktura përgjegjëse për integrimin pranë Ministrisë së Drejtësisë
Funksionimi i Institucioneve Demokratike	1. Procesi zgjedhor: zgjedhje të lira dhe të ndershme, media në fushat zgjedhore, financimi i partive politike në fushat zgjedhore. 2. Funksionimi i parlamenteve në sistemet demokratike: transparenca dhe llogaridhënia, integriteti, eficientia. 3. Roli i shoqërisë civile	- Negociatori i kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore"	- Kryeministria (Departamenti përgjegjës për politikën dhe integrimin në BE); - Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; - Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet; - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) - Ministria e Drejtësisë (MD) - Ministria e Brendshme (MB) - Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) - Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) - Kuvendi - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) - Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) - Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) - Prokuroria e Përgjithshme (PP) - Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve - Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin - Kryeministria (Departamenti përgjegjës për politikën dhe integrimin në BE dhe Departamenti përgjegjës për çështjet regullatore dhe përputhshmërinë) - Ministria e Drejtësisë - Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Struktura përgjegjëse për integrimin në Departamentin e Administratës Publike
Reforma në Administratën Publike	Reforma në administratën publike	- Negociatori i Reformës Administratën Publike		

			- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAK) - Agjencia për Mbështetjen dhe Vetëqeverisjen Vendore - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) - Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje - Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara - Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil - Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) - Avokati i Popullit - Kuvendi - Instituti i Statistikave - Komisioni i Prokurimit Publik - Kontrolli i Lartë i Shtetit	
--	--	--	--	--

NR.PROT. 1819/1
DATE 27.4, 2023

KUVENDIT
KRYEMINISTRISË
TË GJITHA MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE
TË TJERA QENDRORE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAJI

REPUBLICA E SHQIPËRI
KËSHILLI I MINISTRI